



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:047314
Datë: 15.05.2024
Numri i dokumentit: 05690559

C.nr.394/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, gjyqtarja Njomëza Berisha, me bashkëpunëtorin profesional J.N. në çështjen juridiko – kontestimore të paditësit A.A.1. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. B.Sh. nga Prizreni, kundër të paditurit A.A.2. nga Prizreni të cilin me autorizim e përfaqëson av. N.K. nga Prizreni, për shkak të vërtetimit të pronësisë, jashtë seancës, me datë 15.05.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET e tërhequr padia** e paditësit A.A.1. nga Prizreni, kundër të paditurit A.A.2. nga Prizreni, për shkak të vërtetimit të pronësisë.
- II. DETYROHET** paditësi A.A.1. që të paditurit A.A.2. t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumë të përgjithshme prej 1041 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pranë kësaj gjykate paditësi A.A.1. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. B.Sh. nga Prizreni, me datë 12.03.2021 pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurit A.A.2. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. N.K. nga Prizreni, me objekt të padisë vërtetimi i pronësisë.

Me parashtrësën e datës 12.04.2024, i autorizuari i paditësit, av.B.Sh. është deklaruar se paditësi e tërheq padinë me arsyetimin se palët në procedurë janë marr vesh dhe e kanë përfunduar procedurën e trashëgimisë, andaj paditësi nuk ka interes juridik që të vazhdoj me këtë çështje juridike.

Me datë 19.04.2024, gjykata e ka njoftuar të paditurin lidhur me tërheqjen e padisë nga ana e paditësit dhe njëherësh duke e ftuar të njëjtin që brenda afatit kohor prej 7 ditësh nga marrja e njoftimit të deklarohet lidhur me veprimin procedural të palës paditëse për tërheqjen e padisë.

Në nenin 261.2 të LPK-së parashihet: *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.”* Tutje, në nenin 261.4 të po këtij ligji parashihet: *“Kundër aktvendimit me të cilin konstatohet se është tërhequr padia nuk lejohet ankimi.”*

I autorizuari i të paditurit, av.N.K. njoftimin për tërheqje të padisë e ka pranuar me datë 25.04.2024. Me datë 10.05.2024, pranë kësaj gjykate ka deponuar parashitës në të cilën ka theksuar se nuk e jep pëlqimin për tërheqjen e padisë me arsyetimi në bazë të nenin 261 par.2 të LPK-së është paraparë se pas arritjes së përgjigjes në padi lidhur me tërheqjen e padisë kërkohet edhe pëlqimi i palës së paditur, e në rastin konkret pala paditëse ka interes që padrejtësisht të mos privohet nga e drejta e tij për të fituar një vendim lirues nga kërkesëpadia e palës paditëse. Tutje bazuar në nenin 452 par 1 të LPK-së, ka theksuar se pala e cila e humb procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqë fituese ti a shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore, andaj bazuar nga të lartcekurat ka kërkuar nga gjykata që në kuptim të nenit 454 par.2, ta obligoj palën paditës që palës së paditur t’ia paguar shpenzimet e procedurës dhe atë për përgjigje në padi shumë prej 135 euro, për përfaqësim në 6 seanca me nga 101 euro shumë prej 606 euro dhe për 2 ankesa me nga 150 euro, shumë prej 300 euro, e në total shumë e përgjithshme prej 1041 euro.

Gjykata konstatoi se pala e paditur njoftimin e dhënë nga gjykata lidhur me tërheqjen e padisë së paditësit, e ka pranuar me datë 25.04.2024 dhe duke vlerësuar afatin e përcaktuar ligjor për deklarim lidhur me tërheqjen e padisë, e që është afati 7 ditor nga marrja e njoftimit nga ana e palës së paditur, gjykatës i rezulton se ky afat ka skaduar me datë 02.05.2024, përkatësisht në ora 24:00 të datës 02.05.2024. Andaj çdo deklarim përtej këtij afati nuk mund të merret parasysh sepse ligjdhënësi e ka përcaktuar saktë periudhën për deklarim dhe e ka përcaktuar çartë çka ndodh nëse pala nuk deklarohet në këtë afat.

Andaj, mbi këtë bazë gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e konstatuar tërhequr padinë e paditësit A.A.1. kundër të paditurit A.A.2. pasi që vërtetoi se pala e paditur nuk është deklaruar në afatin 7 ditor për tërheqjen e padisë dhe si e tillë konsiderohet se ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.

Gjykata lidhur me vendimin si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, përkatësisht lidhur me kërkesën e palës së paditur për kompensimin e shpenzimeve procedurale vendosi duke u bazuar në nenin 456 par.1 të LPK-së, ku parashihet se *“Paditësi që e tërheqë padinë ka për detyrë që të paditurit t’ia shpërblej shpenzimet procedurale përveçse kur tërheqjen e padisë e ka bërë menjëherë pas përmbushjes së detyrimit nga ana e të paditurit”*. Në rastin konkret gjykata ia njohu të paditurit shpenzimet si në vijim: për përgjigje në padi shumë prej 135 euro, për përfaqësim në 6 seanca gjyqësore prej nga 101 euro, përkatësisht shumë prej 606 euro si dhe për dy ankesa shumë prej nga 150 euro, përkatësisht shumë prej 300 euro, e në shumë e përgjithshme prej 1041 euro.

Numri i lëndës: 2021:047314
Datë: 15.05.2024
Numri i dokumentit: 05690559

Për arsyet e dhëna si më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPRATAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr.394/2021, dt.15.05.2024

G j y q t a r j a
Njomëza Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër vendimit në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa. Ndërsa kundër vendimit në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate.